

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Komisioneri i Këshillit të Evropës: Glorifikimi i Ratko Mlladiqit është vepër penale
ADRESA	https://indeksonline.net/komisioneri-i-keshillit-te-evropes-glorifikimi-i-ratko-mlldiqi-t-eshte-veper-penale/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 01:02:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	4 shtator 2026, 10:30:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	51c4a52578a94957d3ce1f76d0f3695b81c1203ac65eb3a0676cbfcf8209d5e1
TEKSTI	587d1efa16cf508f4e46f554a97797bd0efcf62bdad6f1637e8b852dfb882b70
PAMJA	9d744b59d1e97f2d629712f832dd471887bdd19bc8ea6912b1f9f8332007719f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e1ec282450d7f1a50d58b6ed944b2300c12ee65f00ba6192f0bd07a662d968bc
E MËPARSHMJA	50671486c4d62bbf9dc047ac2ceb53cbb8bd056d2eef03c310b58116409ed72
RRËNJA MERKLE	89f030d876ccea6b0e23b6ac39c6b069c94f8f32995a6e60ca310d5733a1b6e5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e1ec282450d7f1a50d58b6ed944b2300c12ee65f00ba6192f0bd07a662d968bc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)







SHPËRNDAJE








12:30 / E Premte, 04 Shtator 2026 / S Z

Komisioneri i Këshillit të Evropës: Glorifikimi i Ratko Mlladiqit është vepër penale



Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Michael O’Flaherty, ka dënuar publikisht glorifikimin e ish-komandantit të Ushtrisë së Republika Srpskas, Ratko Mlladiq, i dënuar me burgim të përjetshëm për gjenocid dhe krime lufte në Bosnje e Hercegovinë.

O’Flaherty, tha se dënon çdo formë të lavdërimit publik të Mlladiqit, duke përfshirë deklaratat e zyrtarëve në entitetin serb të Bosnjës, Republika Srpska, si edhe në Serbi.

Sipas tij, madhërimi i kriminelëve të luftës të dënuar përbën vepër penale sipas ligjeve të Bosnjë e Hercegovinës dhe nuk mbrohet nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

“U bëj thirrje të gjitha autoriteteve që të kundërshtojnë glorifikimin e kriminelëve të dënuar të luftës dhe të përbushin detyrimet e tyre ligjore për të siguruar përgjegjësi, për të mbrojtur të drejtat e viktimave dhe për të ruajtur drejtësinë”, tha O’Flaherty.

Deklarata e tij vjen në një kohë kur në Serbi po zhvillohen diskutime rreth ceremonive të varrimit të Mlladiqit dhe mënyrës se si zyrtarët e lartë serbë do të sillen ndaj tij.

Më herët, ministri irlandez për Çështjet Evropiane, Thomas Byrne, vendi i të cilit aktualisht mban presidencën e Këshillit të BE-së, kishte paralajmëruar se një funeral shtetëror për Mlladiqin apo pjesëmarrja e zyrtarëve të qeverisë serbe në ceremoninë e varrimit do të ishte e papranueshme për Bashkimin Evropian.

Byrne tha se, edhe nëse nuk organizohet zyrtarisht një funeral shtetëror, pjesëmarrja apo nderimi i Mlladiqit nga zyrtarë të lartë të qeverisë serbe do të ishte gjithashtu i papranueshëm.

Ratko Mlladiq u dënua në Hagë me burgim të përjetshëm. Në vitin 2021, aktgjykimi përfundimtar e shpalli atë fajtor për 10 nga 11 pikat e aktakuzës, përfshirë gjenocidin në Srebrenicë, përndjekjen dhe bëmbimin e popullsisë, terrorizimin e civilëve gjatë rrethimit të Sarajevës dhe marrjen peng të pjesëtarëve të forcave paqeruajtëse të OKB-së.

Gjykata e Hagës konstatoi se Mlladiq ishte përgjegjës për gjenocidin ndaj rreth 8 mijë boshnjakëve në Srebrenicë në korrik të vitit 1995, si dhe për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe shkelje të ligjeve të luftës. /REL


Mos i humb

- [Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)






- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)



- [“I ke 30 minuta... Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman që i dëboi nga Prizreni ushtarët serbë?](#)



- [Shoferi i duhur gjobitet 2 herë, brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie](#)

- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)

- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'e përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)

- [Aksident i rëndë në autostradën "Tbrahim Rugova", të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



Të fundit nga Lajme

- [00:05 / E Hënë, 07 Shtator](#)
[26-vjeçari plagoset me thikë në Tiranë](#)
- [23:25 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Një person me probleme shëndetësore u shkakton lëndime dy familjarëve, arrestohet nga policia](#)
- [23:13 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Tragjike në Rahovec: I mituri gjendet i plagosur me armë zjarri, mjekët konstatojnë vdekjen](#)
- [22:56 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Dyshohet se sulmuan kapitenin Besart Ahmeti, dy të dyshuarit janë djemtë e këtij polici](#)
- [22:28 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Gjendet pa shenja jete një person në Mitrovicë](#)
- [22:10 / E Diele, 06 Shtator](#)
[Shqipëri, Ministria e Mbrojtjes: 20 vatra zjarri në vend, 11 mbeten aktive](#)

TEL Redaksia: +383 (0) 48 36 36 39 | Marketing: +383 (0) 49 686 666 **EMAIL** info@indeksonline.net | marketing@indeksonline.net [Indeksonline.net](https://www.indeksonline.net)



Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte vetse një kërkesë e kohës.

Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.!!

© 2010 - 2026 Portali Indeksonline. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.